



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KURBIN

Nr. 476 Prot.

Kurbin, më 04.08.2025

Lënda: Njoftim për aplikim lista në pritje

Në zbatim të udhëzimit Nr.8 dt 03.05.2024 të MAS "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të Portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar me udhëzimin Nr 19, datë 29.08.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr 8 datë 03.05.2024 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të Portalit "Mësues për Shqipërinë", pika 1, shkronja d, në rast se për pozicionet e lira në ZVAP nuk paraqiten kandidatë të interesuar për tu punësuar në vendet vakante nga lista e portalit të ZVAP-it dhe DRAP-it përkatës sipas pikës 11 të këtij kreu, atëherë nga ana e ZVAP vijohet me kandidatë të tjerë të interesuar, të cilët kanë paraqitur kërkesë dhe janë renditur sipas pikëve nga ZVAP. Lista e kandidatëve të renditur të kësaj kategorie bëhet publike në faqen elektronike zyrtare të ZVAP dhe dërgohet në DRAP, jo më vonë se tre ditë përpara fillimit të vitit shkollor dhe përditësohet sipas nevojave gjatë vitit shkollor. ZVAP Kurbin ju informon se mund të dorëzojnë dosjet me dokumentacionin përkatës të gjithë kandidatët e interesuar për t'u punësuar pranë kësaj zyre arsimore të cilët nuk janë pjesë e portalit Mësues për Shqipërinë.

Dokumentat që duhet të përmbajë dosja janë si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim;
- CV (**Kujdes:** Adresa email duhet të jetë e saktë pasi komunikimet do jenë vetëm me anë të emailit);
- Kopje e noterizuar e diplomave (bachelor, master) dhe listës së notave;
- Kopje e noterizuar e licensës (nëse e zotëroni);
- Dëshmi e njohjes së gjuhëve të huaja e noterizuar (nëse e zotëroni);
- Librezë pune e noterizuar (nëse e zotëroni);
- Certifikata trajnimesh me kredite të noterizuara (nëse i zotëroni);
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se nuk jeni në procedim penal;
- Raport mjeko-ligjor.

Dorëzimi i dosjeve do të bëhet nga data **04 gusht 2025** deri me datë **18 gusht 2025** me anë të shërbimit postar në adresën e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kurbin. Pas vlerësimit të të gjitha dosjeve do të bëhet renditja e tyre sipas pikëve dhe do të kalojnë te **LISTA NË PRITJE**.

DREJTOR

Teuta Mara

